



**FORCA**

E RE DEMOKRATIKE  
NOVA DEMOKRATSKA SNAGA  
NEW DEMOCRATIC FORCE

**PROGRAMI ZGJEDHOR PËR QEVERISJEN  
E KOMUNËS SË ULQINIT  
2010 - 2014**



Të nderuar bashkëqytetarë,

Nëpërmjet këtij dokumenti ne dëshirojmë të propozojmë programin zgjedhor që partia FORCA e Re Demokratike ka përgatitur për të qeverisur Komunën e Ulqinit në vitet 2010-2014. Partia jonë, ndryshe nga partitë e tjera shqiptare që janë provuar në pushtet më parë dhe kanë përgjegjësi lidhur me problemet që përball komuniteti ynë, konkurren me një moral të lartë, duke mos qenë asnjëherë e komprometuar me pushtetin dhe duke pasur një mision të qartë fisnik si bazë të veprimtarisë së saj. FORCA në këto zgjedhje lokale garon jo vetëm me një ekip profesionistësh të përbërë nga kuadro të kualifikuar, me përvojë të pasur dhe që kanë dëshmuar arritje të larta në fushat e tyre por edhe me një platformë të hollësishme qeverisje.

Ky program dëshmon që ne nuk jemi vetëm një parti e dinjitetshme me kuadro të aftë por edhe një parti vizionare e cila iu ofron qytetarëve një alternativë të qartë dhe të mirë menduar. Ne nuk duam ta bindim votuesin me formë por me përmbajtje duke ofruar këtë program si një kontratë në dorën e qytetarit me anën e së cilës ai mund të na kontrollojë e kërkoj llogari për çdo vonesë apo mosrealizim.


Ky program përveç trajtimit të disa prej çështjeve thelbësore të ekzistencës së FORCËS, që janë konsolidimi dhe rritja e të drejtave të shqiptarëve në Malin e Zi, forcimi integritit të komunitetit tonë me shqiptarët e viseve të tjera, thellimi i nivelit të decentralizimit, përsheptimi i integritit euro-atlantik, kthimin e pronave ndaj ish pronarëve si dhe mirë-administrimi i Të Mirave Detare i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të Komunës së Ulqinit. FORCA është e vetmja parti që ka strategji dhe projekte konkrete për të zhvilluar ekonominë e komunës dhe për të rritur mirëqenien e qytetarëve të saj.

Prandaj përpara se të vendosni se cilës force politike do ia besoni votën, unë do t'ju isha shumë mirënjohës që t'i

kushtonit sadopak kohë leximit të këtij program për të kuptuar në mënyrë të plotë ofertën politike të Forcës së Re Demokratike.

Duke ju falënderuar paraprakisht për vëmendjen tuaj unë ju ftoj që të bashkoheni me ne dhe të bëheni pjesë e realizimit të këtij program.

Sinqerisht juaji,  
Nazif Cungu

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Nazif Cungu'. The signature is stylized with a large, prominent loop at the top and a long, sweeping tail that ends in a small hook.

## Përmbajtja:

Administrimi i pushtetit lokal.....	7
Të drejtat nacionale.....	8
Decentralizimi i pushtetit.....	10
Të Mirat Detare.....	11
Kthimi i Pronave.....	12
Punësimi.....	13
Turizmi.....	14
Infrastruktura komunale.....	17
Bujqësia.....	19
Industria ushqimore.....	21
Industria e artizanatit.....	23
Industritë e reja të huaja.....	23
Kultura.....	24
Ambienti.....	25
Arsimi.....	27
Shëndetësia.....	28
Sporti.....	29
Diaspora.....	29
Bashkëpunimi me shoqërinë civile.....	30



## **Administrimi i pushtetit lokal**

Me të ardhur në pushtet FORCA do të nis procesin e hartimit të Planit Strategjik të Komunës së Ulqinit duke thirrur ekspertë të njohur vendas dhe të huaj dhe duke siguruar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Gjithashtu, miratimi dhe fillimi i zbatimit të Planit Rregullues të Ulqinit ka për të qenë një ndër hapat e para të ndërmarra nga FORCA sapo të vijë në pushtet, në mënyrë që të ndalojë kaosin e deritanishëm urban dhe ti hapi rrugën zhvillimit të mirëorganizuar e të qëndrueshëm të Komunës së Ulqinit.

Kur të vij në pushtet në Komunën e Ulqinit, FORCA do të sigurojë implikimin dhe ndikimin e Komunës në procesin e privatizimit dhe do të sigurojë që ky proces të jetë transparent dhe profesional për objektet e ngelura pa privatizuar duke siguruar që blerësit të jenë investitorë sa më serioz – partnerë strategjik dhe duke garantuar që buxheti i komunës të përfitojë në dobi të qytetarëve.

Komuna e administruar nga FORCA do të mbrojë pronën publike dhe s’do të lejojë që të bëhen ndryshime në këtë pronë pa pëlqimin e Kuvendit Komunal duke mos lejuar të bëhen privatizime apo investime nga qeveria qendrore pa u pyetur qeverisja lokale dhe vetë qytetarët.

Komuna do të aplikojë transparencën e plotë duke qenë gjithnjë e më e hapur me qytetarin, mediat dhe shoqërinë civile duke garantuar një luftë pa kompromis kundër korrupsionit.

FORCA do të garantojë punësimin sipas meritave dhe shpërblimin e punonjësve në varësi të talentit, përkushtimit dhe etikës profesionale duke i dhënë fund praktikave të deritanishme të punësimeve të politizuara, krahinore, klanore dhe familjare.

FORCA dëshiron që në administrimin e Komunës së Ulqinit të aplikojë teknologji, përvoja, teknika dhe praktika më të avancuara dhe profesionale të qeverisjes lokale duke nxitur mes të tjerave një partneritet privat publik.

## **Të drejtat nacionale**

Për të mbrojtur të drejtat e popullit shqiptar në Mal të Zi FORCA jo vetëm që do të përdorë instrumentet dhe legjislacionin shtetëror dhe do të bëjë presion pranë pushtetit qendror por, në mënyrë të veçantë, si asnjë parti tjetër politike shqiptare deri tani, do të përdorë gjerësisht legjislacionin dhe institucionet ndërkombëtare.

FORCA do të shfrytëzojë me profesionalizëm në maksimum legjislacionin dhe mekanizmat ndërkombëtare për t'i bërë presion shtetit të Malit të Zi për të avancuar sa më shumë të drejtat e pakicës shqiptare në këtë shtet. Në vijim janë përmendur disa prej ligjeve apo organizatave ndërkombëtare të cilat janë parashikuar të përdoren për këtë qëllim:

Traktatet e Kombeve të Bashkuara që monitorojnë të drejtat e pakicave duke i vënë theks të veçantë Komitetit të të Drejtave të Njeriut (UN Human Rights Committee), Grupit të Punës së Kombeve të Bashkuara për Pakicat

(United Nations Working Group on Minorities) si dhe UNESCO-s.

Të drejtat e pakicave në kuadër të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (European Convention on Human Rights )

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ( The International Court of Justice)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ( European Court of Human Rights)

Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Etnike ( The Framework Convention for the Protection of National Minorities)

Karta Evropiane e Gjuhëve Krahinore ose Minoritare (The European Charter for Regional or Minority Languages)

Kuadrin për mbrojtjen e të drejtave të pakicave të Këshillit të Evropës si dhe Organizatës Evropiane për Siguri dhe Bashkëpunim ( OSCE)

Standardet, mekanizmat dhe kushtet e vendosura nga Bashkimi Evropian dhe kriteret e Kopenhagenit që lidhen me mbrojtjen e pakicave dhe parandalimin e diskriminimit.

Përveç mekanizmave dhe hapësirave të mundësuar nga e drejta ndërkombëtare dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare, FORCA do të përpiqet për të mundësuar marrëveshje bilaterale midis Malit të Zi dhe Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe Kosovës që të kenë si qëllim përmirësimin e gjendjes së pakicës shqiptare në Malin e Zi.

Në Programin e vet FORCA gjithashtu ka parashikuar se për të përmirësuar gjendjen e pakicës shqiptare do të lidhet në

bashkëpunim të ngushtë edhe me shoqërinë civile të Malit të Zi dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare me peshë që merren me të drejtat e minoriteteve. Të tilla organizata ndërkombëtare janë Minority Rights Group International , International Helsinki Federation for Human Rights, European Centre for Minority Issues etj.

## **Decentralizimi i pushtetit**

FORCA e ka një ndër prioritetet e saja thelbësore ngritjen e nivelit të decentralizimit dhe konsolidimin e vet-administrimit lokal të Komunës së Ulqinit. Me marrjen në dorë të administrimit të Komunës së Ulqinit, FORCA do të:

- Vendos në funksion të plotë ingerencat ekzistuese të Komunës së Ulqinit
- Shfrytëzoj deri në maksimum hapësirën ligjore ekzistuese në Mal të Zi për të siguruar sa më shumë vet-administrim të Komunës së Ulqinit
- Përqendroj energjitë e saja për të eliminuar diskriminimin që i bëhet Komunës së Ulqinit lidhur me kompetencat, autoritetin e saj dhe investimet
- Mundësoj zgjerimin e kompetencave administrative dhe fiskale të Komunës së Ulqinit

Për të realizuar këto objektiva FORCA do ta transformojë administrimin e Komunës së Ulqinit në një shembull të mirë në gjithë Malin e Zi në mënyrë që kjo komunë të fitojë më shumë besim për ta merituar dhënien e më shumë kompetencave. FORCA ka për të shfrytëzuar mbrojtjen ndërkombëtare ligjore për drejtat e pakicave për të mundësuar zgjerimin, avancimin dhe forcimin e ingerencave lokale të Komunës së Ulqinit. Ajo gjithashtu ka për të lobuar tek qeveria e Malit të Zi, si dhe tek aktorët ndërkombëtarë për të mundësuar synimet e sipërpërmendur. Disa prej institucioneve ndërkombëtare ndaj të cilave do të drejtohet

FORCA për mbështetje lidhur me garantimin e maksimumit të vet-administrimit lokal në Komunën e Ulqinit janë:

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës (Congress of Local and Regional Authorities) pranë Këshillit të Evropës, si dhe përmbushja e Kartës Evropiane e Vet-Administrimit Lokal (European Charter of Local Self-Government)

Bashkimi Evropian, lidhur me kushtet e integritit evropian të Malit të Zi që kanë të bëjnë me qeverisjen vendore dhe nivelin e decentralizimit.

Komiteti Këshillimor i Kombeve të Bashkuara për Autoritetet Lokale (United Nations Advisory Committee of Local Authorities).

### **Të Mirat Detare**

Një ndër motivet kryesore të krijimit të FORCËS ka qënë padrejtësia që është bërë me Të Mirat Detare në kurriz të qytetarëve të Komunës së Ulqinit. Padrejtësia dhe diskriminimi vihen re qartë tek zbatimi me dy standarde i ligjit duke diskriminuar shqiptarët ndërkohë që zbatimi është krejt ndryshe në Komuna të tjera të bregdetit të Malit të Zi. Përpos kësaj shqetësues është edhe fakti që ndryshe nga ajo që parashikon ligji, të Mirat Detare janë shëndrruar në të Mira "Tokësore" duke kontrolluar dhe shfrytëzuar shumë më tepër territor se sa i takon.

FORCA premtan që me marrjen e pushtetin në Komunën e Ulqinit do të përdor çdo mjet legjitim që është në dorë të Komunës për ti përdorur resurset natyrore në shërbim të banorëve. Ajo do të zbatojë modelet më të mira dhe më të suksesshme të administrimit të bregdetit që njihen dhe aplikohen, duke ftuar ekspertë e këshilltarë nga Kroacia dhe Italia, etj.

FORCA do të luftojë keq-menaxhimin e zonës të të Mirave Detare dhe do të luftojë që menaxhimi i të Mirave Detare të bëhet edhe nga pushteti lokal në Komunën e Ulqinit e jo vetëm nga niveli qendror.

### **Kthimi i Pronave**

Kthimi i Pronave mbetet një ndër çështjet me më shumë rëndësi dhe ndër prioritetet e FORCËS. Gjatë procesit të deritanishëm të kthimit të pronave në Mal të Zi janë marrë vendime politike që i kanë dëmtuar shqiptarët. Ky proces ka aplikuar standarde të dyfishta duke diskriminuar pakicën shqiptare dhe për këtë arsye:

FORCA do të luftojë me mjete ligjore qoftë në nivelin vendas dhe qoftë në nivelin ndërkombëtar për të eliminuar diskriminim që iu bëhet shqiptarëve lidhur me pronat dhe për të mundësuar realizimin e të drejtës së shqiptarëve në Malin e Zi për kthimin e pronave. Rasti më flagrant i mos respektimit të të drejtave themelore e legjitime të anëtarëve të pakicës shqiptare është Valdanosi.

Probleme të pronës private të shqiptarëve hasen edhe me pronarët legjitim në Shtojë, Anë të Malit, në Shipçanik të Tuzit. Gjithashtu shfrytëzimi i pronave të shqiptarëve në Parkun Nacional të Bjeshkëve të Nemuna si dhe të pronave private në brezin e të Mirave Detare duhet realizuar duke marrë parasysh interesat e pronarëve.

FORCA është e angazhuar që të përdorë të gjithë mundësitë ligjore brenda Malit të Zi për të mundësuar zgjidhjen e këtyre problemeve. Ajo do përpiqet në nivel lokal dhe qendror që pronat e ish pronarëve, pa dallim përkatësie, të kthehen dhe po ashtu do t'iu drejtohet gjykatave vendase ose të huaja për të realizuar këtë qëllim.

FORCA do të kërkojë mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe të vendeve mike për këtë çështje, si dhe do të përpiqet të sigurojë bashkëpunim prej organizatave të ndryshme ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, Komisioni i Helsinkit apo Unioni Ndërkombëtar i Pronës së Patundshme (Union Internationale de la Propriete Immobiliere) për të lobuar në zgjidhjen e çështjes së kthimit të pronave. Gjithashtu do të bashkëpunojmë edhe me organizata dhe institucione brenda Malit të Zi të cilat e kanë për qëllim kthimin e pronave.

## **Punësimi**

FORCA premtan që për 4 vitet e ardhëshme në drejtimin e Komunës së Ulqinit do të krijojë kushte për hapjen e të paktën 1500 vende të reja pune. Zbatimi i programit tonë ekonomik do të mundësojë një zhvillim intensiv në Komunën e Ulqinit dhe do të mundësojë hapjen e vendeve të shumta të punës duke e zvogluar papunësinë dhe varfërinë që mbizotëron në komunën tonë.

FORCA ka parashikuar që plani i saj i veprimit në fushën e Turizmit do ta lulëzojë këtë sektor duke hapur rreth 700 vende të reja pune në hoteleri, restorante, bare e shërbime të tjera turistike.

FORCA e ka përcaktuar bujqësinë si shtyllën e dytë të ekonomisë së Komunës dhe sapo të vij në pushtet do të përqendrojë një pjesë të mirë të energjisë, vëmendjes dhe buxhetit drejt këtij sektori duke garantuar 600 vendeve të reja të punës.

FORCA është e vetëdijshme për potencialin që ka komuna jonë për të zhvilluar sektorë të tjerë të ekonomisë si industrinë e lehtë dhe sektorin e shërbimit dhe është e bindur që në këto sektorë të ekonomisë do të punësohen të paktën 200 punonjës.

FORCA gjat ushtrimit 4 vjeçar të pushtetit të Komunës do të përpiqet edhe për të siguruar mundësi punësimi sezonal jashtë vendit për qytetarët e komunës. FORCA do të hulumtojë mundësi të punësimit për periudha të shkurtëra të profesionistëve të sektorit hotelierik në vende evropiane që kanë sezon dimëror turistik masiv.

Një tjetër mundësi që do të përdoret nga FORCA ka për të qenë edhe organizimi i punësimit afatshkurtër të bujqëve të Ulqinit në vendet e zhvilluara perëndimore, gjatë periudhave që kanë nevojë për shërbime intensive bujqësore.

FORCA do të përpiqet të rris pjesëmarrjen e kuadrove shqiptarë në administratën publike që varet prej pushtetit qendror. Nëpërmjet autoritetit të Komunës dhe të deputetit FORCA do të bëjë presion në Podgoricë që sa më shumë shqiptarë të kualifikuar të mund të punësohen në institucione të ndryshme publike, si në nivel ministrie, ashtu edhe në nivel lokal, duke bërë që sa më shumë kuadro të diplomuar shqiptarë të gjejnë mundësi punësimi si zyrtarë në sektorë të ndryshëm si arsimit, policia, shëndetësia, gjyqësori, prokuroria etj.

## **Turizmi**

FORCA do të bëjë përgatitjet për realizimin e Masterplanit të Turizmit për Ulqinin dhe ndërtimin e komplekseve të hoteleve të kategorisë së lartë. Përgatitjet do të përfshijnë nxjerrjen e vendimeve për studime të lokacionit, ndërtimin e infrastrukturës komunale, përgatitjen e projekteve dhe përkrahjen e realizimit të tyre.

FORCA do të përpiqet të bëjë përmirësimin e akomodimit individual duke përfshirë në mënyrë sa më profesionale kapacitetet dhe traditën e krijuar gjatë shumë viteve prej

qytetarëve tonë në ofertën turistike të Komunës së Ulqinit. Me ardhjen në pushtet FORCA do të vërë në jetë një strategji të posaçme të hartuar vetëm për këtë qëllim.

Planifikimi i zhvillimit të turizmit shëndetësor në komunën e Ulqinit duke nxitur ndërtimin e qendrave kurative që ofrojnë shërbime terapeutike ose rehabilituese për të moshuar, pushues të sëmurë ose sportistë.

Promovimi sa më profesional i turizmit të Komunës së Ulqinit duke angazhuar kompanitë më cilësore të marketingut për të bërë një promovim dinjitoz ndërkombëtar të turizmit.

Nxitja e turizmit sportiv duke bërë që komuna të merret seriozisht me promovimin e sporteve ujore për ta bërë më interesant qëndrimin e turistëve në Ulqin si dhe për të tërhequr të apasionuarit e këtyre sporteve që të vijnë e t'i ushtrojnë në Ulqin gjatë dhe jashtë sezonit turistik. Të tilla sporte që do meritojnë vëmendje janë zhytja, noti, surfing, vindsurfing, kitesurfing, lundrim me vela, vozitja e kanoeve, kajakëve.

Stimulimi i krijimit të një shkolle që të trajnojë të interesuar nga Mali i Zi dhe nga jashtë vendit për të ushtruar këto sporte dhe për ta shndërruar Ulqinin në një qendër të sporteve të lartpërmendura. Kjo shkollë të shërbejë edhe si selia e një muzeut të detarisë dhe anije-ndërtimtarisë së Ulqinit.

Zhvillimi i agro-turizmit duke huazuar nga përvojat më të mira ndërkombëtare, në zonat piktoreske të Komunës së Ulqinit (si psh. buzë Bunës e në Shas ) për ta bërë sa më të larmishme dhe të gjatë ofertën turistike të Komunës së Ulqinit.

Nxitja e sporteve në natyrë që synojnë të mundësojnë tërheqjen e turistëve të rinj edhe jashtë sezonit të verës. Këto sporte ose aktivitete në natyrë mund të jenë gjuetia, peshkimi, ngarja e makinave 4X4, harqet, hiking, paragliding, trekking, mountainbiking, alpinizmi dhe birdwatching – soditja e shpezëve.

Nxitja e rezervateve të gjuetisë në komunën e Ulqinit si dhe të fermave që merren me mbarështimin e kafshëve të egra për të tërhequr sa më shumë turistë gjuetarë gjatë sezonit dimëror si dhe për të pasuruar ofertën ushqimore të restoranteve dhe hoteleve të Ulqinit gjatë verës.

Mundësimi i rihapjes të ambienteve të ndryshëm për turistët që kërkojnë aventurë ose eksplorim - hapja e kampeve.

Studimi dhe aplikimi i mundësive për turizëm elitare si dhe përkrahja e sporteve elitare si kalërimi, golfi, tenisi, harqet apo lundrimi.

Promovimi i turizmit kulturor duke meremetuar monumentet, bërë gërmime arkeologjike të reja, shtuar aktivitetet folklorike, nxitur prodhimet e artizanatit dhe eksplorimet etnografike. Të realizohet projekti “Kalaja - Ulqin, Kalaja - Shas vende që do ti vizitohë çdo turist” me dhënie të prioritetit realizimit të aktiviteteve kulturore, hapja e dyqaneve të prodhimeve artizanale, përmirësimi i akomodimit individual, zhvillimi i eventeve të ndryshme çdo ditë gjatë sezonit, përmbajtje zbavitëse ( Kazino ) dhe përmbajtje tjera të ndryshme të cilat do të ishin në dispozicion të qytetarëve gjatë tërë vitit.

Shndërrimin e Ulqinit në një qendër ndërkombëtare konferencash duke ofruar ambiente për aktivitete të tilla me çmime tërheqëse në mënyrë që të tërhiqen vizitorë edhe jashtë sezonit dhe që të arrihet një reputacion ndërkombëtar.

Identifikimi dhe bërja e atyre investimeve infrastrukturore që kanë për qëllim shtimin e numrit të turistëve, e tillë mund të konsiderohet realizimi i rrugës që lidh Shtojin në Mal të Zi me Shtojin e Shqipërisë që të integrohet turizmi i bregdetit të këtyre dy shteteve.

Synimi i FORCËS do të jetë hapja e vijave lundruese Ulqin-Velipojë- Shën Gjini-Durrës, Ulqin – Shkodër përmes Bunës, Ulqin - Boka e Kotorrit dhe Ulqin - Dubrovnik.

Në bashkëpunim me kompanitë hotelerike FORCA do të sigurojë bursa dhe programe të trajnimit dhe për të siguruar cilësinë e burimeve njerëzore të Komunës duke rritur sa më shumë cilësinë e shërbimeve hotelerie dhe gastronomike.

### **Infrastruktura komunale**

FORCA ka si qëllim që më së pari të bëhet Plani hapësinor i Ulqinit dhe të bëhet aplikimi me rigorozitet i tij, sepse kjo është më se e nevojshme për zhvillimin afatgjatë të qytetit si vend turistik si dhe për të vënë disiplinë në ndërtimtari.

Duhet të bëhen përpjekje serioze që Katastri të kalojë në kompetencat e Komunës.

Pasi të marrë administrimin e Komunës së Ulqinit Forca do të angazhohet menjëherë për të zgjidhur sa më shpejt problemin e mijëra objekteve të ndërtuara pa leje. Nëpërmjet legalizimit të këtyre objekteve do të mund të vilen më shumë të ardhura të cilat do të përdoren për të investuar në infrastrukturën e përbashkët të këtyre zonave. Strategjia e vjeljes së këtyre taksave do t'i përshtatet mundësive financiare të banorëve të Ulqinit.

FORCA ka si projekt që Komuna të investojë për ndërtimin e infrastrukturës së një zone industriale në Krythë të Anës së Malit që ka një pozicion strategjik pasi aty kalojnë rrugët që lidhin Ulqinin me Shqipërinë, Krajën dhe Tivarin. Kjo zonë do të tërheqë investime në industrinë ushqimore, artizanale dhe të prodhimtarisë.

Rruga ndërkomëtare Ulqin-Sukobinë do të jetë prioritet për realizimin e projekteve të mësipërme. FORCA ka qëllim që ky aks rrugor të ketë standardet Evropiane të cilësisë dhe sigurisë.

FORCA synon që komuna të ndërtojë sa më shpejt rrugën Pinjesh – Gjerana në mënyrë që të lidhen shkurt dy pjesët e qytetit. Ky investim mundëson dhe ndërtimin e objekteve të reja.

Planifikimi dhe realizimi i projektit për rregullimin e Porto Milenës do të jetë njëri nga prioritetet që në vitin e parë të qeverisjes.

Përmirësimi i Infrastrukturës komunale (kanalizimi, përpunimi i ujërave të zeza, ujësjellësi, ndriçimi i rrugës, trotuari ) në Ulqin dhe Shtojë. Posta dhe ambulanca në Shtojë duhet të funksionojë gjatë tërë vitit.

Komuna e Ulqinit pas fitores së FORCËS do të angazhohet që të sigurojë ndriçimin e fshatrave të lëna pas dore.

Për të zgjidhur problemin e trafikut të ngjeshur në verë Komuna duhet ta rregullojë parkimin në disa rrugë problematike dhe do të planifikojë ndërtimin e garazheve për parkim.

## Bujqësia

FORCA e konsideron zhvillimin e bujqësisë si shtyllën e dytë për të zhvilluar Komunën e Ulqinit dhe synon t'i kushtojë shumë vëmendje dhe energji këtij sektori për disa arsye :

- Do të zvogëloj papunësinë dhe ul varfërinë në zonën rurale të komunës duke e ndaluar emigracionin masiv të deritanishëm,
- Zhvillimi i bujqësisë do ta ndihmojë ndjeshëm sektorin e turizmit duke siguruar ushqim të mjaftueshëm e të freskët për nevoja të vendasve dhe të turistëve,
- Do të siguroj lëndë të parë për zhvillimin e një industrie ushqimore konkurruese për të plotësuar nevojat e vendit por edhe për eksport.
- Do të mundësonte një aktivitet të pasur ekonomik dhe të ardhura të vazhdueshme për komunitetin dhe buxhetin e komunës edhe gjatë periudhës kur nuk ka sezon turistik.

Prandaj FORCA ka në plan që të ndër marrë hapat e mëtejshme :

Të rigjenerojë bujqësinë duke siguruar investime infrastrukturore që kanë për qëllim përmirësimin e sistemit të vaditjes dhe kullimit.

Të promovojë bujqësinë në Komunën e Ulqinit duke tërhequr investime, ndihmuar me financime, subvencionime dhe kreditime me kushte të volitshme, sidomos për blerjen e makinerive bujqësore, plehrave kimik, insekticideve apo pesticideve, farërave dhe fidanëve.

Të ndërtojë nëpërmjet partneritetit privat-publik të qendrave të grumbullimit dhe distribuimit të produkteve

bujqësore, të bimëve mjekësore, fryteve të egra si dhe të frigoriferëve të specializuar për mirëmbajtje.

Të stimulojë në mënyrë të veçantë sektorët me potencial të madh zhvillimi si ullishtarinë, pemëtarinë dhe hortikulturën.

Të nxisë përdorimin e serrave, teknikave dhe teknologjive të reja të bujqësisë.

FORCA do të mbështesë dhe do të nxisë zhvillimin e blegtorisë në Komunën e Ulqinit në mënyrë që të rritet prodhimi i qumështit, mishit, leshit, lëkurave dhe të nxitet industria e lidhur me këto nënprodukte.

Subvencionimi dhe mbështetja në organizimin e shpërndarjes së qumështit do të jenë prioritete të pushtetit lokal.

Për të mundësuar zhvillimin e blegtorisë FORCA do të nxisë edhe kultivimin e tokave me bimë që ti shërbejnë blegtorisë si jonxhë (tërfonjë), lakër foragjere si dhe do të nxisë mirëmbajtjen e kullotave që gjenden në territorin e komunës.

Forca do të nis të hulumtojë duke marrë përvojat shkencore të huaja për kultivimin e kulturave të reja:

- Lulet apo bimët industriale që shërbejnë për farmaceutikë apo kozmetikë.
- Fruta apo perime që nuk janë kultivuar më parë por që janë të përshtatshme për klimën dhe tokën si për shembull, kërpudhave, asparagos etj.
- Hapja e fermave të kulturave të reja që po gjejnë sukses në vende fqinj si për shembull bletaria, prodhimi i kërmijve për eksport (që kanë pasur sukses në Bosnjë dhe Kosovë) makushat ose strucët (që janë provuar me sukses në Shqipëri), drerët etj.

FORCA gjithashtu ka një ndjeshmëri të theksuar ndaj ambientit dhe e sheh zhvillimin e Ulqinit të lidhur ngushtë me konservimin e natyrës që do t'i sigurojë jetëgjatësi edhe turizmit. Gjithashtu në tregjet ndërkombëtare është vënë re një rritje e kërkesës për produkte bujqësore organike. Përpos kësaj ofrohen mundësi grantesh dhe kreditime me kushte të volitshme nga shtete dhe institucione ndërkombëtare për të aplikuar bujqësinë organike. FORCA do të angazhohet që në bashkëpunim të ngushtë me fermerët të aplikojë për të shtënë në dorë sa më shumë fonde të huaja dhe nga qeveria qendrore si dhe duke përdorur edhe buxhetin e saj për nxitje të zhvillimit të bujqësisë organike në Komunën e Ulqinit.

FORCA do të studiojë me vëmendje të madhe mundësitë e shfrytëzimit të pasurisë ujore të Komunës së Ulqinit për të nxitur Akuakulturën. Konkretisht, do të angazhojë ekspertë të njohur për të zhvilluar mundësitë e kultivimit artificial të peshqve, guacave, apo produkteve të tjera detare në bregdetin e Adriatikut si dhe në ujërat e ëmbla të liqenit të Shasit dhe Bunës.

## **Industria**

### **Industria ushqimore**

Forca mendon se Komuna e Ulqinit ka potencial për të zhvilluar industrinë ushqimore dhe do të stimulojë me forma të ndryshme investimet në këtë fushë. Konkretisht me prospektivë të mirë zhvillimi janë fabrikat apo punishtet që merren me:

- Përpunimin, paketimin apo konservimin e perimeve, frutave dhe kompostove
- Pikat e grumbullimit, tharjes dhe paketimit të bimëve mjekësore, çajrave dhe erëzave të ndryshme

- Punishtet që merren me prodhimin e produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme.
- Punishtet e ëmbëlsirave, biskotave apo lëngjeve freskuese dhe të frutave
- Tharje ose konservim peshku, guacave e sardeleve.
- Përmirësimin e kualitetit të vajit të ullirit dhe nënprodukteve të tjera
- Fabrika për prodhimin e produkteve nga qumështi.

### **Industria e ndërtimit**

Komuna e Ulqinit ka një traditë të mirë në fushën e industrisë të ndërtimit me kuadro të zotë me një nivel të lartë profesionalizmi dhe përvojë të pasur. Kapacitetet materiale, kapitale dhe njerëzore të ndërtimit të Komunës së Ulqinit në të ardhmen do të jenë bazë për ndërtimet infrastrukturore dhe hotelerike që priten të ndërtohen në territorin tonë. Megjithatë FORCA beson se këto potenciale mund të kanalizohen edhe në profile të tjera të industrisë së ndërtimit duke:

- Ndërtuar fabrika të reja ose konsoliduar ato ekzistueset që merren me mobilierinë duke patur parasysh jo vetëm tregun vendas por edhe atë të huaj
- Eksploruar mundësinë e ndërtimit të fabrikave të prodhimit të baltës që merren me prodhimin e tjegullave, pllakave, vazove etj.
- Fabrika që merren me prodhimin e parafabrikateve nga betoni
- Fabrika që merren me nxjerrjen dhe përpunimin e gurëve dekorativ

## **Industria e artizanatit**

FORCA e ka si objektiv thelbësor të ekzistencës së saj ruajtjen, kultivimin dhe nxitjen e trashëgimisë sonë të pasur kulturore e folklorike dhe beson se kjo trashëgimi e çmuar jo vetëm që i duhet përcjelle e pasur dhe e plotë brezave të tjera, por mund të shërbejë njëherazi edhe si një instrument i vlefshëm zhvillimi. Prandaj FORCA do të nxis ringjalljen e prodhimeve të artizanatit, prodhimin masiv të produkteve tradicionale e suvenirëve që të shërbejë si mbështetje edhe ndaj industrisë së turizmit. Disa prej fushave ku mund të zhvillohet zejtaria dhe të marre përmasa domethënëse ekonomike janë argjendaria, qëndistaria, produktet e tezgjahut si qilimat e sixhadetë, punimet e drurit, punime hekuri, bakri i rrahur, gdhendjet e gurit si dhe trikotazhi.

## **Industritë e reja të huaja**

Duke patur parasysh pozicionin e favorshëm gjeografik, FORCA beson se tek ne ekziston një potencial i madh për ndërtimin e manufakturave të kompanive të huaja që duan të transferojnë në vendet më pak të zhvilluara një pjesë të proceseve të prodhimit. FORCA është e bindur që nëse Komuna e Ulqinit do të krijonte një klimë të përshtatshme, ndërmernte promovimet e duhura në nivel ndërkombëtar, përmirësonte procedurat administrative dhe shërbimet publike si dhe të bënte investimet e duhura infrastrukturore, do të mund të thithte investime të konsiderueshme të huaja. Këtu përparësi të madhe kanë bizneset evropiane që kanë për të transferuar një pjesë të procesit të prodhimit në vende që kanë krahë të lirë pune pa nevojitur kualifikim të madh profesional , sikurse ka ndodhur me investimet në rrobaqepësi, fabrika lëkure dhe fabrika të prodhimit të këpucëve të kompanive me emër në vende si Rumania e Shqipëria.

## **Kultura**

Objektet tona historike, për të cilat ia vlen të krenohemi në Ballkan falë FORCËS nuk kanë për tu lënë më pas dore. Kalaja e Ulqinit dhe e Shasit do të mbrohen dhe restaurohen plotësisht.

Gjurmime të reja arkeologjike dhe etnografike do të bëhen për të nxjerrë në pah traditën tonë lavdi plotë.

FORCA do të do të luftojë pranë organeve qendrore dhe atyre ndërkombëtare që Kalaja dhe Shasi, objektet kulturore të mbrohen dhe të kryhen investime për monumentet e kulturës, jo thjesht për të ruajtur e kultivuar traditën por për të nxitur dhe turizmin kulturor.

Në Kala komuna gjithashtu do të impenjohet që të bëhet pastrimi i bedenave nga mbeturinat dhe bimët e ndryshme si dhe ndriçimi profesional i mureve gjatë mbrëmjes.

Në Qendrën për Kulturë mendojmë se duhet vazhduar me përvojën e mirë të promovimit të librave dhe revistave, dhe plotësimi të fondit të librave me tituj të rinj në të dy gjuhët.

Mundësimi i hapjes së kinemasë së qytetit dhe rikthimi dhe kultivimi i traditës ulqinake të lundrimit me vela.

Përveç aktiviteteve ekzistuese do të organizohen të tjera veprimtari si dita e Ullirit, solemnitete kusarësh, festivalet e folklorit, dita e Servantesit dhe Dullçinejës, dita e Kublës etj.

Pasurimi i jetës kulturore, sportive dhe artistike për të bërë sa më joshës rajonin tonë për turistët. Ndërtimi i ambienteve të reja moderne sportive si dhe parqeve të lojërave për fëmijë.

Në bashkëpunim me institucionet arsimore, Komuna e administruar nga FORCA do të përpiqet që të kultivojë trashëgiminë tonë folklorike nëpër shkolla dhe të ndihmojë në avancimin e talenteve të reja të muzikës, pikturës apo të sporteve të ndryshme.

FORCA do të iniciojë themelimin e Teatrit Kombëtar Shqiptar në Ulqin si dhe themelimin e orkestrës profesionale muzikore pran Qendrës për kulturë.

## **Ambienti**

FORCA do të bëjë përpjekjet maksimale të administratës së komunës për eliminimin e ndotjes dhe mbajtjen pastër të ambienteve publike.

Lidhur me planifikimin e territorit pushteti qendror ka ende kompetenca në pjesën më atraktive të territorit të komunës (Morsko Dobro). Për ti dhënë fund kaosit që mbizotëron FORCA do të bëjë çmos që këto kompetenca të kalojnë në dorë të Komunës në mënyrë që të zbatohet principi i konventave evropiane të cilat parashikojnë që planifikimi i territorit të bëhet nga popullata lokale.

Fillimi i realizimit të një projekti për ndërtimin e fabrikës për përpunimin e ujërave të zeza, fekaleve dhe kolektorëve të kanalizimit, posaçërisht për zonën e Port Milenës dhe Shtojës, si dhe ndërtimi i deponisë sanitare regjionale për mbeturina të ngurta.

Përkrahja e organizatave joqeveritare lokale për të ndërmarrë nisma pastrimi, mbjelljesh apo fushata promovuese dhe vetëdijësuese për rëndësinë e ambientit.

Komuna nën pushtetin e FORCËS do të përpiqet që lumi Buna dhe liqeni i Shasit të promovohen dhe të deklarohen zonë e mbrojtur dhe e lundrueshme. Gjithashtu do të bëjë

rregullimin, mbrojtjen dhe rivitalizimin e zonës së pishave që në këtë periudhë është në rrezik.

Prej komunës do të ndërmerren fushata pyllëzimi në zonat e rrezikuara nga erozioni.

Komuna do të stimulojë hedhjen e vezëve të peshkut në liqenin Shasit për të nxitur peshkimin sportiv në funksion të turizmit.

Ndërhyrje pastruese në vende që kanë rëndësi të madhe për ambientin në përgjithësi dhe turizmin në veçanti:

- Pastrimi i kanalit ekzistues që lidh Liqenin e Shasit me Bunën.
- Ndërtimi i kolektorëve për pjesën e Limanit.
- Organizimi i pastrimit të fundit detit nga Limani deri në Albatros.

FORCA ka si objektiv gjithashtu që nëpërmjet komunës të bëhet sistematizimi i grumbullimit të bërllogut dhe deponimi i tyre duke zgjidhur në mënyrë të veçantë problemin e bërllogut të rrezikshëm( akumulatorëve, vajrave motorike, autogomave, ngjyrave etj.

Lidhur me deponinë sanitare FORCA synon që të përshejtohet transferimi i deponisë nga lokacioni aktual në lokacionin e caktuar Mozhura dhe që "Hija" të sanohet dhe mos të përdoret më për grumbullimin e mbeturinave.

FORCA do të bëjë të mundur që Policia komunale të organizohet si shërbim cilësor dhe rigoroz sanitar për të kontrolluar, mbikëqyrur dhe garantuar standardet më të larta higjieno-sanitare në ambientet e shërbimeve publike dhe private, si për shembull restorante, hotele, klube etj.

## Arsimi

Sigurimi i mjeteve materiale nga qeveria qendrore, donatorët ndërkombëtarë, fondet e buxhetit të Komunës dhe burime të tjera për të përmirësuar infrastrukturën shkollore të Komunës, pasuruar bazën materiale dhe bibliotekat shkollare, për të financuar ndërtimin ose përmirësimin e ambienteve sportive të shkollave si dhe blerjen e instrumenteve muzikorë dhe mundësimin e programeve artistike në shkolla.

Angazhimi i Komunës për të përmirësuar tekstet mësimore në shqip, duke nxitur për publikime më cilësore si dhe përkthime më profesionale të redaktuara mirë që respektojnë sa më shumë gjuhën standarde shqipe.

Promovimi i trajnimeve profesionale që pajisin rininë me specializime hotelerike apo të gatimit, me njohuri të gjuhëve të huaja, aftësi të transferueshme dhe aftësi teknike për ti bërë sa më konkurrent në tregun e punës si dhe për ti bërë burimet njerëzore të komunës sa më tërheqëse për investime të huaja.

Organizimi i seminareve, trajnimeve dhe konferencave mes arsimtarëve shqiptarë për të mundësuar përmirësimin e aftësive dhe shkëmbimin e përvojave.

Dhënia e shpërblimeve dhe bursave për nxënësit më të mirë të Komunës së Ulqinit për të motivuar përgatitjen e tyre sa më të mirë shkollore.

Lobimi i FORCËS nëpërmjet Komunës së Ulqinit për të siguruar sa më shumë të drejta studimi për maturantët e komunës në universitetet perëndimore si dhe në Podgoricë, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni.

Stimulimi i aktivitete jashtëshkollore të tipit ekipe dhe veprimtari sportive, klube artistike, aktivitete kulturore, konkurse, ekskursione apo vizita.

Mbledhja e fondeve për bursa të dhëna nga komuna në partneritet me komunitetin e biznesit për të rinj të dalluar të Komunës që të studiojnë në fusha specifike që lidhen me prioritetet e komunitetit si për shembull turizmi, decentralizimi i qeverisjes lokale, urbanistika, mirëmbajtja e monumenteve kulturore e të natyrës etj.

Themelimi i shkollës së mesme profesionale për profesione të nevojshme për prodhimtari dhe shënime të cilat janë bazë e zhvillimit të ekonomisë.

Themelimi i shkollave të larta bazuar në partneritetin publik dhe privat për nevoja të studimit në shkenca të cilat janë të nevojshme për mbështetje të zhvillimit të Ulqinit.

## **Shëndetësia**

FORCA në drejtimin e komunës së Ulqinit do të ndikojë drejtpërdrejt në pushtetin qendror me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në komunë.

FORCA vlerëson si shumë të rëndësishme përmirësimin e menjëhershëm të gjendjes së paisjeve mjekësore në shtëpinë e shëndetit dhe maternitet. Modernizimi i paisjeve ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve. Në këtë kuadër prioritet i FORCËS është mundësimi i sallës së kirurgjisë në maternitetin e qytetit tonë.

FORCA gjithashtu do të ndikojë në pushtetin qendror me qëllim rritjen e nivelit profesional të mjekëve nëpërmjet specializimeve permanente.

FORCA vlerëson si shumë të rëndësishme ofrimin e bursave për studime në mjekësi për studentët Shqiptar.

Me fitoren e FORCËS në komunë të Ulqinit do të mundësohet bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare shëndetësore si OBSH apo organizata të tjera që mbulojnë aspekte të shëndetit si UNICEF për ofrimin e praktikave më të mira dhe cilësore në fushën e shëndetësisë.

## **Sporti**

Sportit do ti kushtohet vëmendje e vecantë me qëllim që të jetë në funksion të të rinjve dhe ngritjes së vlerave turistike.

Me fitoren tonë do të punojmë në përmirësimin e infrastrukturës dhe terreneve sportive. Në çdo lagje, fshat dhe qendra urbane do të ndërtojmë komplekse sportive. Dy investime përmblendhëse do të jenë halla e sporteve dhe pishina.

FORCA obligohet që klubet sportive të kenë financim të rregullt nga buxheti komunal.

## **Diaspora**

FORCA është e vetëdijshme për rolin e pazëvendësueshëm të diasporës sonë në mundësimin e mirëqenies së qytetarëve dhe ka planifikuar një program specifik për të mbajtur lidhje të ngushta me diasporën dhe për të nxitur bashkëpunimin më të.

FORCA ka synim që me ardhjen në fuqi në Komunë, t'i japë mundësi diasporës që t'i dëgjohet zëri duke iu ofruar organizatave përfaqësuese të diasporës sonë një status konsultativ për veprimtaritë e Komunës së Ulqinit.

FORCA do të përpiqet që të sigurojë një ambient sa më të përshtatshëm dhe tërheqës për të thithur investimet e pjesëtarëve të diasporës.

Thjeshtëzimi i procedurave administrative dhe përmirësimi i shërbimeve komunale të nevojshme për pjesëtarët e diasporës në mënyrë që ata të ndihen sa më të afërt dhe të mirëpritur në Ulqin.

Mundësimi i kryerjes së disa prej shërbimeve të nevojshme për emigrantët shqiptarë nëpërmjet postës dhe internetit duke e bërë më të lehtë për ata bashkëpunimin me Komunën.

Mbajtja e administratës së Komunës në funksionalitet të plotë gjatë sezonit të pushimeve në mënyrë që emigrantët që kthehen me pushime dhe që duan të kryejnë procedura e shërbime administrative të mos hasin pengesa e vonesa.

Mbështetja e vizitave dhe shfaqjeve të grupeve tona artistike në diasporë , atje ku janë më të përqendruar emigrantët tonë, për të mbajtur ndezur lidhjen e tyre me vendlindjen si dhe për t'i çmallur me vlerat e trashëgimisë tonë kombëtare.

### **Bashkëpunimi me shoqërinë civile**

Kur FORCA ta marrë në dorë drejtimin e Komunës së Ulqinit ka për të aplikuar një politikë të plotë transparence dhe bashkëpunimi e konsultimi me shoqërinë civile.

Organizatat Joqeveritare kanë për të patur statusin e vëzhguesit dhe konsultuesit gjatë veprimtarisë zyrtare të Komunës së Ulqinit.

Për të stimuluar akoma më tej shoqërinë civile në Komunën e Ulqinit, FORCA ka menduar që Komuna të vërë në

dispozicion të organizatave joqeveritare të reja apo të brishta, ambiente të komunës me qira simbolike që do përdoret për të mbuluar shpenzimet bazike të ambienteve. Përveç kësaj Komuna do të vërë në dispozicion fonde që do të shpërndahen në mënyrë meritokratike për projekte të hartuara nga organizatat joqeveritare të Ulqinit që i shërbejnë të mirës së komunitetit.

Komuna nën administrimin e FORCËS jo vetëm që ka për të qenë e hapur ndaj shoqërisë civile por ka për të bashkëpunuar ngushtë me të në rastet kur përputhen qëllimet dhe objektivat si për shembull në aktivitete artistike, kulturore, mjedisore apo bamirësie.

FORCA e shikon me shumë rëndësi zhvillimin e mediave shqiptare prandaj ka për synim që të nxisë Komunën që të mbështesë mediat e shkruara dhe elektronike në shqip.

Nën administrimin e FORCËS do të ketë një bashkëpunim më të ngushtë edhe me institucionet fetare, jo vetëm në meremetimin dhe mirëmbajtjen e atyre objekteve fetare që janë monumente kulturore por edhe nëpërmjet një bashkëpunimi më të ngushtë në organizimin e festave fetare.



Forca e Re Demokratike - Nova Demokratska Snaga FORCA  
Bul Skenderbeu p.n. 85360 Ulqin – Ulcinj  
Mali i Zi, Crna Gora, Montenegro  
Tel: . +382 30 401 760, Fax: +382 30 401 761  
E-mail : info@forca.me Web: [www.forca.me](http://www.forca.me)

# **FORCA E ZHVILLIMIT SNAGA RAZVOJA**

